



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 03/L-088

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut 2008/13 MBI MIRATIMIN E
BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE SHPENZIMEVE TË
AUTORIZUARA PËR PERIUdhËN 1 JANAR DERI MË 31 DHJETOR 2008**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut 2008/13 mbi Miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës dhe Shpenzimeve të Autorizuara për Periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2008 "Rregullorja")

Duke marrë parasysh nevojën për të ndryshuar Rregulloren në mënyrë që të arrihet pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet tjera relevante,

Miratton këtë

**LIGJ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE
SHPENZIMEVE TË AUTORIZUARA PËR PERIUdhËN 1 JANAR DERI 31
DHJETOR 2008**

Neni 1

Secilën herë që përmendet "Rregullorja" në Rregullore, ajo do të zëvendësohet me fjalën "Ligji". Pas çdo përmendje të "AKM-së" në Rregullore me përjashtim të Ndërmarrjeve Publike, do të shtohen fjalët "Agjencioni Kosovar i Privatizimit" me ligjin për Agjencionin Kosovar të Privatizimit Nr 03/L-067 .

Neni 2

Teksti i tërë pjesës hyrëse të Rregullores të zëvendësohet me formulimin në vijim:

"Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në bazë të autoritetit të dhënë me nenin 65.1, dhe 120 të Kushtetutës,
Ne bazë le ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048,
Me anë të kësaj miraton si vijon:

**LIGJ PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KONSOLIDUAR TË KOSOVËS DHE
SHPENZIMEVE TË AUTORIZUARA PËR PERIUdhËN 1 JANAR DERI 31
DHJETOR 2008**

Neni 3

Neni 2 i Rregullores të shprehja me “Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm” zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës me akt nënligjor në përputhje me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë 03/L-048.

Neni 4

Neni 3.2 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me zëvendësohet fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 3.3 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të fshihet në tërësi.

Neni 5

Në nenin 4, paragrafi 2 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 4, paragrafi 4 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 4, paragrafi 5 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 4, paragrafi 8 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 4, paragrafi 10 të Rregullores shprehja Urdhëresë Administrative zëvendësohet me fjalën akte nënligjore

Neni 6

Neni 5, paragrafi 3 të Rregullores shprehja fjala Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm fshihet në tërësi.

Neni 7

Neni 6, paragrafi 1 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të fshihet në tërësi

Neni 6, paragrafi 6 të Rregullores shprehja Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 6, paragrafi 7 të Rregullores shprehja UNMIK-u të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 6, paragrafi 9 fshihet.

Neni 8

Në nenin 7, paragrafi 3 të Rregullores, shprehja "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm " të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ne nenin 7, paragrafi 4 shprehja Rregullorja e UNMIK-ut 2003/17 të zëvendësohet me Ligjin e Kuvendit 03/L-048.

Në nenin 7 paragrafi 5 të Rregullores, shprehja "Këshilli Ekonomik Fiskal " të fshihet

Neni 7 paragrafi 6 i Rregullores fshihet.

Neni 9

Neni 8, paragrafi 2 pika (c) e Rregullores, shprehja "autorizohet shprehimisht nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm" të zëvendësohet me shprehjen "bartet në rezervën e Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave".

Neni 10

Neni 9 paragrafi 1 i Rregullores shprehja "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm " të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 9, paragrafi 2 fshihet shprehja "ne përputhje me nenin 27 te Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive te shpallur përmes Rregullores së UNMIK-ut 2003/17" dhe shtohet fjalia "ne përputhje me nenin 30 te Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësiive 03/L-048".

Neni 9, paragrafi 3 i Rregullores fshihet.

Neni 9, paragrafi 4 i Rregullores shprehja "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm " të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 9, paragrafi 6 i Rregullores shprehja "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm " të fshihet.

Neni 11

Neni 10, paragrafi 2 i Rregullores shprehja "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm " të fshihet.

Neni 10 paragrafi 3 i Rregullores shprehja "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm " fshihet.

Neni 12

Neni 12 fshihet dhe ne vend te tij vendoset teksti ne vijim: "Ne pajtim me ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048, Ministri i Ekonomisë dhe Financave ka autoritetin që subjektit te caktuar, te paraqitur ne pasqyrën A te ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë ti sigurojë një hua te kthyeshme apo kredi nga fondi i konsoliduar i Kosovës, ne shumën dhe sipas kushteve për te cilat është arritur pajtimi me Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Shumat maksimale te miratuara për kreditë ose huat e tilla janë përcaktuar ne pasqyrë 2. Huaja apo kredia e kthyeshme do te bazohet ne një marrëveshje te arritur ne mes te subjektit te caktuar i cili e merr duanë apo kredinë dhe Ministrisë se Ekonomisë dhe Financave, te miratuar nga institucionet përgjegjëse ne pajtim me legjislacionin ne fuqi.

Neni 13

Neni 13 i Rregullores shprehja "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm " të zëvendësohet me fjalën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Neni 14

Ky Ligj hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/L-088
13 qershor 2008

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI

